



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 79, datë 30. 11. 2022

**“PËR DËRGIMIN E KËRKESËS SË FAMILJARËVE TË RESUL QERIM ALUSHANI,
PËR TRAJTIM PRANË KOMISIONIT QËNDROR TË STATUSI DËSHMOR I ATDHEUT”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 30. 11. 2022, mori në shqyrtim projektaktin, dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni Këshillimor i Dhënies së Titujve Vendorë të Nderit, në zbatim të Ligjit Nr. 109/2018, “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 11, Komisionet vendore, pika 3. Në zbatim të Ligjit Nr. 109/2018, “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 11, pika 4, për kërkesën e paraqitur nga familjarët e Resul Qerim Alushani, për vlerësimin e figurave të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare

VENDOSI:

1. Të dërgojë kërkesën e familjarëve të Resul Qerim Alushani, për trajtim pranë Komisionit Qëndror të Statusi “Dëshmor i Atdheut”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Sekretare Këshillit Bashkiak
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 9 - vota pro , vota kundër - s'ka , 1- votë abstenim.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

